



**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT**

Prill 2024

NJOFTIM

Në kuadër të projektit *Erasmus+* midis **Hochschule Hannover, Gjermani** dhe **Universitetit Bujqësor të Tiranës**, shpallet thirrja për aplikime për shkëmbim studentësh për Semestrin e Dytë 2023-2024 (*Semestri i Verës*), në Hannover, Gjermani.

Në këtë projekt mund të aplikojnë studentët e *Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU)*. Thirrja është e hapur për **2 (dy) kuota** për të zhvilluar praktikën profesionale për një periudhë kohore 2 – 3 mujore.

Nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës (**UBT**), si partner i projektit, bëhet një renditje paraprake e studentëve aplikues. Kjo renditje u dërgohet partnerëve. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është si më poshtë:

- Letër motivimi në anglisht
- Lista e notave
- CV në anglisht (Formati *Europass*)

Afati i fundit për aplikim është data **29 Prill 2024**.

Dokumentacioni i kërkuar do duhet të dërgohet nëpërmjet email-it në adresën: erasmusoffice@ubt.edu.al dhe apeculi@ubt.edu.al

Për më shumë informacion na vizitoni pranë zyrës së Projekteve dhe Kërkimit në UBT.